



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË
INDUSTRIËS DHE ENERGJISË**

Nr. 5382/1 prot.

Tiranë, më 19 . 3 . 2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1450, datë 25.01.2010.

SHOQËRISË "RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN" SHA
Lagjia "Beqir Dardha", Rruga "Tomorr Sinani, Nr. 77/4, Elbasan

Për dijeni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë

Shoqëria "Rruga Ura Asfaltim Nr.2, Elbasan" sha është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1450, datë 25.01.2010, për mineralin gur gëlqeror, në objektin "Letan", Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse AKBN, me shkresën nr.5803, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5382, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr. 1450, datë 25.01.2010, për mineralin gur gëlqeror, në objektin "Letan" Elbasan, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit, siç është përcaktuar në nenin 31, pika 5, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015 në shumën 14 844 501 lekë.

Leja nr.1450, datë 25.01.2010, është dhënë në përputhje me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, "Minerar të Shqipërisë", të ndryshuar, i cili është shfuqizuar me ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Shkresa me propozimin e AKBN-së i është dërguar edhe shoqërisë tuaj për dijeni dhe pas këtij njoftimi ju keni bërë kërkesë në adresën e Institucionit tonë, me nr. 45, datë 08.08.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.5382/2, datë 09.08.2017, duke

kundërshtuar propozimin e mësipërm dhe keni bërë argumentimin Tuaj, pse e kundërshtoni këtë propozim. Në kërkesën tuaj thoni se zona e prekur nga shfrytëzimi është më e vogël se ajo që është marrë në llogaritje, për vlerën vjetore të rehabilitimit mjedisor prej 3.6 milion lekë në vit. Sipas pikës 7, nenit 31, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për lejet e dhëna më para, duhet të përcaktohej vlera e rehabilitimit vjetor të mjedisit, sipas procedurave të përcaktuara me akte nënligjore, që kanë dalë në zbatim të ligjit të sipërcituar. Kjo është përcaktuar për lejen nr.1450, datë 25.01.2010, që ju zotëroni, në vlerën 3.6 milion lekë në vit dhe me legjislacionin që është në fuqi, nuk mund të korrigjohet për t’u zvogëluar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gërmën “ç”, të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit 1450 datë 25.01.2010, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Letan”, Elbasan, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes së shfrytëzimit nr.1450, datë 25.01.2010, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “Letan”, Elbasan.

Në zbatim të nenit 49, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

